



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1010/31 prot

Datë 12.08.2024

V E N D I M

Nr. 1031/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.08.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 621/2024, datë 04.06.2024 dhe nr. 961/2024 datë 24.07.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NUIS K21511002I dhe adresë: Rruga ‘Shefqet Musaraj’ banesa nr.17, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Durrës
Lagja nr.8, Rr.A.Goga, Durres.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 04.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 621/2024, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "ALMedical" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur e thjeshtuar", me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: "Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës", me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 29.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "ALMedical" SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Në datë 24.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 961/2024, ku vendosi:

- 1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës", me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.*
- 2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimet Nr. 621/2024, datë 04.06.2024 dhe Nr.840/2024, datë 09.07.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.3. Në datën 08.08.2024 është protokolluar në KPP me nr. 1010/28 prot., shkresa e autoritetit kontraktor, nr. 1028/9 prot., datë 05.08.2024 me objekt: "Për zbatimin e vendimit nr 961/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1010/26 prot., dt.24.07.2024", me anë të së cilës autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës njofton se ka zbatuar vendimin Nr 961/2024/2024, datë 24.07.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit "E hapur e

thjeshtuar”, me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: “*Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës*”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës. Bashkëngjitur kësaj shkrese autoriteti kontraktor ka sjellë në KPP shkresën me nr. 1028/8 prot., datë 29.07.2024 me objekt: “*Relacion mbi zbatimin e Vendimit të KPP-së nr.961/2024 regjistruar me tonën me nr. 1028/5 prot., datë 26.07.2024*”, në të cilën janë pasqyruat ndryshimet e dokumentave të tenderit me objekt: “*Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës*”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Në datë 24.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 961/2024, ku vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.*
2. *Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimet Nr. 621/2024, datë 04.06.2024 dhe Nr.840/2024, datë 09.07.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.2. Në datën 08.08.2024 është protokolluar në KPP me nr. 1010/28 prot., shkresa e autoritetit kontraktor, nr. 1028/9 prot., datë 05.08.2024 me objekt: “*Për zbatimin e vendimit nr 961/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1010/26 prot., dt.24.07.2024*”, me anë të së cilës autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës njofton se ka zbatuar vendimin Nr 961/2024/2024, datë 24.07.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: “*Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës*”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës. Bashkëngjitur kësaj shkrese autoriteti kontraktor ka sjellë në KPP shkresën me nr. 1028/8 prot., datë 29.07.2024 me objekt: “*Relacion mbi zbatimin e Vendimit të KPP-së nr.961/2024 regjistruar me tonën me nr. 1028/5 prot., datë 26.07.2024*”, në të cilën janë pasqyruat ndryshimet e dokumentave të tenderit me objekt: “*Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës*”.

Nga shqyrtimi i shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 1028/8 prot., datë 29.07.2024 me objekt: “*Relacion mbi zbatimin e Vendimit të KPP-së nr.961/2024 regjistruar me tonën me nr. 1028/5 prot., datë 26.07.2024*”, në të cilën janë pasqyruat ndryshimet e dokumentave të

tenderit me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës”, rezulton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 961/2024, datë 24.07.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës”.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

